



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Gllgocit
Zyra e Kryetarit



Nr 01-360/03-2369 dt. 15/01/2025

Bazuar në Ligjin Nr.03/L040 për Vetëqeverisje Lokale, Ligjin Nr 03/L-164 për Financimin e Programeve të Veçanta të Banimit konkretisht nenin 3, parag. 1, pika 1.1, nenin 4 të Udhëzimit Administrativ Nr. 23/2010, për Procedurat e Shpalljes së Programeve të Veçanta të Banimit, Udhëzimit Administrativ Nr. 22/2010 për Procedurat e Përfitimit nga Programet e Veçanta të Banimit, Programi Komunal Tre Vjeçar për Banim 2023-2025 Nr. 01-400/01-45971 dt. 12/09/2023, Kryetarit të Komunës, Komisioni për çështjet e banimit të përkohshëm sociale shpall këtë:

**THIRRJE PUBLIKE PËR APLIKIM PËR SHFYTËZIMIN E
PËRKOHËSHËM TË BANESAVE
ME QIRA JOPROFITABILE NË BANIMIN E PËRKOHSHËM SOCIAL
TEK BLOKU I DHE II NË DRENASIN III**

Pasi që Kontratat mbi shfrytëzimin e përkohshëm të banesave me qira joprofitabile ne objektet e Banimit të Përkohshëm Social, në Blllokun I dhe Blllokun II në Drenasin III, në Komunën e Drenasit janë në skadim, njoftojmë të gjithë banuesit e banimit të përkohshëm social se aplikimi fillon prej datës 15/01/2025 deri 13/02/2025.

Në këto programe mund të aplikojnë edhe kategoritë e familjeve që :

- Nuk kanë banesë/shtëpi në pronësi individuale
- Posedojnë sipërfaqe banimi nën normat e banimit të përcaktuara për kategorit sociale dhe ekonomike.
- Familjet që kanë mbetur pa banesë apo shtëpi si rezultat i dëmtimit të shtëpive gjatë luftës në Kosovë.

Kriteret për përcaktimin e radhës së përparësisë janë:

1. Statusi i Banimit;
2. Lartësia e të ardhurave;
3. Gjendja shëndetësore;
4. Invaliditeti;
5. Struktura e familjës.

Përparësi në përzgjedhjen e përfituesve kanë :

1. Familjet me shumë fëmijë;
2. Familjet që në përbërjen e tyre kanë persona me aftësi të kufizuara;
3. Familjet ku kryefamiljari është grua-mbajtëse e familjes;
4. Bashkëshorti ose bashkëshortja e shkurorëzuar që ka në përkujdesje fëmijë;
5. Fëmijët me statusin e jetimit

Handwritten signature

Dokumentet e nevojshme për aplikim:

1. Fotokopja e letërnjoftimit për parashtruesin e kërkesës;
2. Certifikatat e bashkësisë familjare;
3. Të dhënat për anëtarët e punësor (nga punëdhënësi) dhe burimet e të hyrave të rregullta;
4. Vërtetim nga Drejtoria për Zhvillim Ekonomik që personi kërkues dhe anëtarët e familjes nuk kryejnë aktivitet tregtar;
5. Vërtetim nga Enti për punësim për të gjithë anëtarët e familjës të papunë;
6. Të dhënat mbi gjendjen shëndetësore të parashtruesit të kërkesës apo të anëtarëve të familjës, të lëshuar nga ana e enteve shëndetësore të autorizuara ose të komisioneve profesionale;
7. Vërtetim për dëshminë lidhur me statusin e familjës së dëshmorit;
8. Vërtetim nga autoritetet përkatëse për dëshminë për përkujdesje ndaj fëmijëve jetim;
9. Dokumente të tjera shtesë të nevojshme sipas rasteve.

Marrja dhe dorëzimi i aplikacioneve si dhe informacionet shtesë për dokumentacionet e nevojshme për aplikim mund t'i gjeni në sportelin e Komunës së Drenasit, Kati I (i parë), sporteli nr.10,11 dhe 12, kurse aplikacionet e paraqitura jashtë afatit kohorë dhe të pa kompletuara, konsiderohen të pavlefshme.

Të gjithë personat që nuk aplikojnë brenda afatit të lartëshënuar, e humbin të drejtën për "Banim të Përkohshëm Social" në Komunën e Drenasit.

Afati i paraqitjes së kërkesës fillon prej datës 15/01/2025 deri 13/02/2025,

Kohëzgjatjen e përfitimit nga programet e veqanta të banimit, përkatësisht shfrytëzimi i banesave të Banimit të Përkohshëm Social me qira joprofitabile, sipas kësaj thirrje është në kohë të caktuar prej 2 vitesh, ndërsa numri i banesave që janë në dispozicion për programet e veqanta të banimit është 48 njësi banimi në Bllokun I dhe II të Banimit të Përkohshëm Social.

Pas mbylljes së afatit për dorëzimin e aplikacioneve, Komisioni për vlerësimin dhe përzgjedhjen e familjeve bënë vlerësimin sipas kritereve të përcaktuara në U.A Nr 21/2010.

Komisioni në teren bënë vlerësimin e gjendjes së banimit të familjeve si dhe verifikimin e të dhënave të aplikuesve brenda 30 ditëve.

Lista e familjeve përfituese të shfrytëzuesve të banesave sociale do të publikohet në Web faqen e komunës së Drenasit sipas pikëve të fituara nga vlerësimi i komisionit.

Kundër vendimit të Komisionit përzgjedhës, palët kanë të drejtë ankese me shkrim brenda 30 ditëve ne Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, nga data e publikimit të vendimit.



Kryetari i Komunës

Ramiz Lladrovci